

Në bazë të nenit 38 paragrafi 1. pika 9 e Ligjit mbi vetqeverisjen lokale („Fleta zyrtare e Malit të Zi“ nr.2/18,24/19 dhe 38/20), nenit 58 paragrafi 1 pika 9 e Statutit të Komunës së Ulqinit („Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat e komunes“ nr.48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit , në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2022,ka miratuar,

**Vendimin për dhënien e pëlqimit Sekretariatit për mbrojtjen e pasurisë  
së Komunës së Ulqinit për nënshkrimin e marrëveshjes në lëndën gjyqësore në Gjykatën  
themelore të Ulqinit P.nr. 523/21**

**Neni 1.**

I jepet pëlqim Sekretariatit për mbrojtjen e pasurisë së Komunës së Ulqinit për nënshkrimin e marrëveshjes në lëndën gjyqësore në Gjykatën themelore të Ulqinit P.nr. 523/21 me përmbajtje si në vijim:

Obligohet e paditura Komuna e Ulqinit që në emër të shitjes së patundshmërisë për vitin 2019 t’ia paguaj paditësit Fondit të Kompenzimit nga Podgorica vlerën prej 370.708,00 euro edhe atë në këste :

- Vlerën prej 75.000,00 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes
- Vlerën prej 60.000,00 euro deri me 31.12.2022
- Vlerën prej 60.000,00 euro deri me 31.3.2023
- Vlerën prej 60.000,00 euro deri me 30.06.2023
- Vlerën prej 60.000,00 euro deri me 30.09.2023
- Vlerën prej 55.708,00 euro deri me 31.12.2023

Obligohet Komuna e Ulqinit që paditësit t’ia kompenzoj kostos e procedurës në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

Në rast se Komuna e Ulqinit vonon në rastin e pagimit të obligimeve të dy kësteve të njëpasnjëshme, paditësi është i autorizuar që në mënyrë të dhunshme ta bëjë pagesën e tërë borxhit nëpërmjet Organeve kompetente.

Me këtë marrëveshje përfundojnë të gjitha obligimet dhe detyrat për këtë çështje dhe paditësi heq dorë nga kamatat prej me 31.12.2019.

**Neni 2**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë prej ditës se shpalljes në „Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunes“.

**KUVENDI KOMUNËS SË ULQINIT**

**Nr: 02– 016/22-228-6  
Ulqin ,29.07.2022.**

**K R Y E T A R ,  
Ardijan Mavriq, d.v.**